Nr. 121 prot
19. 02. 2021

MARRËVESHJA E BASHKIMIT ME PËRTHITHJE

Ndërmjet

SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË SHA

Si Shoqëri përthithëse

Dhe

TIPOGRAFIA USHTARAKE SHA

Si shoqëri e përthithur

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË - MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË - TIPOGRAFIA USHTARAKE - TIRANË

MARRËVESHJE BASHKIMI ME PËRTHITHJE

E SHOQËRISË "TIPOGRAFIA USHTARAKE" SH.A

NGA SHOQËRIA "SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË" SH.A

Kjo marrëveshje bashkimi me përthithje është hartuar nga:

Administratori i shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a, Z. Besmir HYSA

Dhe

Administratori i shoqërisë " Tipografia Ushtarake" sh.a, Znj Fabiola DRINI (HOXHA)

Ky projekt është iniciuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si aksioneri i vetëm i shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a, Tiranë dhe i shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a, Tiranë.

Në përputhje me ligjin Nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar, pjesa IX, neni 215 deri tek neni 225 me vendim të aksionerit të vetëm të shoqërive hartohet kjo Marrëveshje për bashkimin me përthithje të shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a, nga shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a.

Me vendimin Nr.1 datë 04/01/2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë është urdhëruar:

1. Bashkimi me përthithje i shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a, nga shoqëria "Shtypshkronja e letrave me vlerë" sh.a.
2. Të hartohet marrëveshja dhe raporti i bashkimit sipas nenit 216 të ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008 " Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar
3. Shoqëria e re përthithëse do të quhet "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë"sh.a Tiranë.
4. Administratori i shoqërisë përthithëse do të jetë Z. Besmir HYSA, administrator aktual i shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë"sh.a sh.a Tiranë.
5. Eksperti kontabël Znj. Anita Pulaj të hartojë raportin e bashkimit, sipas nenit 217 të ligjit 9901, datë 14/04/2008 " Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar
6. Shoqëria " Tipografia Ushtarake" sh.a, Tiranë pas përfundimit të bashkimit, vlerësohet e prishur, sipas nenit 220 të ligjit 9901, datë 14/04/2008 " Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar, ndaj crregjistrohet nga QKB, sipas seksionit V të ligjit Nr.9723, datë 03/05/2007 " Për Regjistrin e Biznesit.

7. Të zmadhohet kapitali i shoqërisë përthithëse sipas vlerës së përcaktuar nga Eksperti kontabël.

Në zbatim të këtij vendimi të aksionerit të dyja shoqëritë kanë rënë dakord për të hartuar këtë Marrëveshje, në mënyrë që të përcaktojnë afatet dhe kushtet e të drejtave dhe të detyrimeve respektive në përputhje me procesin e bashkimit.

<u>Të dyja shoqëritë kanë rënë dakord si më poshtë vijon:</u>

<u>Përkufizime dhe Interpretime</u>

Në këtë Marrëveshje, përvecse kur kuptohet ndryshe ose kur cilësohet ndryshe më tej, fjalët e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

- **"Marrëveshje"** nënkupton këtë Marrëveshje
- **"Shoqëri Përthithëse"** në këtë Marrëveshje do të thotë Shoqëria "Shtypshkronja e letrave me vlerë"sh.a
- **"Shoqëri e Përthithur"** në këtë Marrëveshje do të thotë Shoqëria "Tipografia Ushtarake"sh.a
- **"Data e realizimit përfundimtar të bashkimit" (data efektive e bashkimit)** ka kuptimin që i është dhënë në paragarafin e mëposhtëm që do të thotë, data e miratimit të Marrëveshjes nga aksioneri i vetëm dhe i depozitimit të këtyre dokumentave në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.
- **"Data e bashkimit"** ka kuptimin që i është dhënë në paragrafin e datës kontabël që do të thotë data 31/12/2019
- **"Informacioni Kofidencial"** nënkupton çdo informacion, me shkrim ose me gojë në lidhje me aktivitetin financiar ose aktivitete të tjera të shoqërive.
- **"Qëndra Kombëtare e Biznesit"** nënkupton njësinë e themeluar në bazë të ligjit nr.923, datë 03/04/2007, "Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit".
- **"Data e nënshkrimit"** nënkupton datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje nga të dyja palët, ashtu siç tregohet në faqet e nënshkruara të kësaj Marrëveshjeje.

Shoqëritë që marrin pjesë në bashkim me përthithje

Shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a, shoqëri aksionere me kapital të regjistruar prej 430,238,000 lekë, i ndarë në 430,238 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion, tërësisht i paguar, me seli tek ish "Tipografia Ushtarake" Tiranë, datë themelimi më 01/09/2008, e përfaqësuar nga administrator i Shoqërisë Z. Besmir HYSA, e cila për qëllim të kësaj marrëveshje do të quhet "Shoqëria Përthithëse".

Shoqëria "Tipografia Ushtarake"sh.a, shoqëri aksionere me kapital të regjistruar prej 66,857,000 lekë, i ndarë në 66,857 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion, tërësisht i paguar, me seli Rruga "Qemal Stafa". Tiranë, datë themelimi më 11/07/1997, e përfaqësuar nga administrator i Shoqërisë Znj. Fabiola DRINI (HOXHA) që për qëllim të kësaj marrëveshje do të quhet "Shoqëria e Përthithur".

Në bazë të kushteve të kësaj Marrëveshje Shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a do të përthithë Shoqërinë "Tipografia Ushtarake" sh.a në datën e realizimit përfundimtar të bashkimit, që është data e miratimit të Marrëveshjes nga aksioneri i vetëm i shoqërive dhe depozitimi i tyre në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria "Tipografia Ushtarake" sh.a do ti transferojë shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a, tërësinë e elementëve të aktivit e të pasivit duke përfshirë dhe ato që rezultojnë nga operacionet e kryera gjatë periudhës ushtrimore deri në datën e bashkimit.

Raporti i këmbimit të aksioneve

Të dyja shoqëritë që marrin pjesë në procesin e bashkimit me përthithje zotërohen nga i njëjti aksioner, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
Kapitali i "Shoqërisë Përthithëse" është në shumën 430,238,000 lekë, i ndarë në 430,238 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion. Nga ndryshimet mëparshme të kapitalit të kësaj shoqërie numri i aksioneve nuk ka ndryshuar, duke zmadhuar kapitalin me rritjen vlerës për secilin aksion.

Kapitali i shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a, nga perthithja e Shoqërise "Tipografia Ushtarake" sh.a Zvogelohet me vlerën 9,575,000 lekë, dhe shuma per 959 lekë do të kalojë në Zvogelimin e zërit rezerva për efekt të rrumbullakimit të vlerës së aksioneve. Pas Zvogelimit nga procesi I bashkimit Kapitali i "Shoqërisë Përthithëse" nga 430,238,000 lekë bëhet 420,663,000 lekë, i ndarë në 420,663 aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksion

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË - MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË - TIPOGRAFIA USHTARAKE - TIRANË

Kushtet e ndarjes së aksioneve si dhe data për ndarjen e fitimit të Shoqërisë përthithëse

Aksionet në "Shoqërinë Përthithëse" zotërohen vetëm nga një aksioner, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duke e konsideruar këtë fakt, nuk ka kushte të ndarjes së aksioneve, si dhe përcaktimin e një date për ndarjen e fitimit.

Data e përcaktuar për trajtimin kontabël të veprimeve të kryera.

Në aspektin e kontabilitetit të gjitha operacionet e veprimtarisë të kryera prej Shoqërisë "Tipografia Ushtarake"sh.a nga data 01 janar 2020 deri në datën e regjistrimit përfundimtar të procesit të bashkimit pranë QKB-së, datë në të cilën do të ndodhë çregjistrimi pa likuidim i Shoqërisë "Tipografia Ushtarake"sh.a, do të konsiderohen si të kryera nga shoqëria Përthithëse "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë"sh.a, dhe regjistrimet kontabël përkatëse do të merren në librat e saj.

Duke qënë se data mbi të cilin do të bëhet bashkimi është data 31/12/2020, bilanci përfundimtar i përthithjes do të jetë bilanci i të dyja shoqërive i datës 31/12/2020.

Të drejta dhe avantazhe të veçanta

Ky operacion bashkimi me përthithje nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë.

Përparësitë e organeve të administrimit

Anëtarët e organeve drejtuese të shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë"sh.a në datën e realizimit përfundimtar të bashkimit do të vazhdojnë të jenë anëtarët e organeve drejtuese të Shoqërisë Përthithëse.

Statuti i shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë"sh.a, mbas ndryshimeve që mund të bëhen do të jetë Statuti i Shoqërisë Përthithëse.

Administrator i Shoqërisë Përthithëse do të jetë Z. Besmir HYSA, i cili do të ushtrojë kompetencat e administrimit të shoqërisë së bashkuar sipas ligjit dhe statutit të shoqërisë.

Selia e Shoqërisë Përthithëse do të jetë Selia e Shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë":
ish "Tipografia Ushtarake" Tiranë

Pasojat që do të ketë bashkimi ndaj punëmarrësve

Punëmarrësit e Shoqërisë "Tipografia Ushtarake"sh.a mbas datës së bashkimit me përthithje do të përfshihen si punëmarrës tek Shoqëria Përthithëse

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË - MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË - TIPOGRAFIA USHTARAKE - TIRANË

Modalitetet

Shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a do të jetë zotëruese e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë "Tipografia Ushtarake"sh.a në datën e bashkimit.

Shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a në datën e realizimit përfundimtar të bashkimit do të zotërojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet, licensat e zotëruara nga shoqëria "Tipografia Ushtarake" sh.a në këtë datë.

Punëmarrësit e shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a do të përfshihen mbas datës së bashkimit si punëmarrës tek Shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a.

Garancitë për kreditorët dhe mbrojtja e tyre

E rëndësishme në këtë procedurë bashkimi me përthithje të shoqërive të mësipërme, është garantimi i kreditorëve të shoqërive që marrin pjesë në këtë bashkim, sidomos ata të shoqërisë së përthithur (të cilat do të jenë pjesë në raportin e ekspertit kontabël), për faktin se:

Debitori fillestar humbet formën ligjore ose çregjistrohet (Shoqëria e përthithur), detyrimet e saj sipas ligjit i transferohen Shoqërisë përthithëse "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a.

Në zbatim të ligjit Shoqëria përthithëse merr përsipër të bëhët pasardhëse e shoqërisë së përthithur në marrrëdhënie me të tretët, duke garantuar në këtë mënyrë kreditorët e shoqërisë së përthithur, që ti drejtojnë të gjitha pretendimet e tyre ndaj Shoqërisë përthithëse "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a.

Ekspertët

Me qëllim, vlerësimin e kushteve të kësaj Marrëveshje të bashkimit, për të dyja shoqëritë pjesëmarrëse, në këtë procedurë bashkimi me përthithje , me vendimin Nr.1 datë 04/01/2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë është emëruar Znj. Anita Pulaj, me nr. ID 030808698, banuese në Tiranë , eksperte kontabël e regjistruar (Audituese ligjore) anëtare e IEKA, mbajtëse e licencës me nr. 155 datë 19/05/2006.

Eksperti ngarkohet sipas ligjit të hartojë një raport me shkrim, nëpërmjet të cilit do të deklarojë dhe vlerësojë kapitalin e shoqërive.

Kapitali i shoqërisë përthithëse, (shoqërisë përfituese të kontributeve) pas realizimit të procesit të bashkimit me përthithjen e shoqërisë "Tipografia Ushtarake"sh.a (shoqëria kontribuese) do të përbëhet nga kapitali I regjistruar I shoqërisë përthithëse në shumën 430,238,000 lekë dhe kapitalet e veta ne vlere negative të "Shoqërisë së Përthithur në shumën **(9,575,959)** lekë,

Kapitali i shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a, nga perthithja e Shoqërise "Tipografia Ushtarake" sh.a Zvogelohet me vlerën 9,575,000 lekë, dhe shuma per 959 lekë do të kalojë në Zvogelimin e zërit rezerva për efekt të rrumbullakimit të vlerës së aksioneve. Pas

Zvogelimit nga procesi I bashkimit Kapitali i "Shoqërisë Përthithëse" nga 430,238,000 lekë bëhet 420,663,000 lekë, i ndarë në 420,663 aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksion

Shoqëritë pjesmarrëse ne këtë proces bashkimi me përthithje, garantojnë sipas ligjit, se ekspertit do ti vihet në dispozicion i gjithë informacioni dhe dokumentat përkatëse, me qëllimin e kryerjes së procedurave ligjore.

Premtime deri në mbyllje dhe pas mbylljes

Deri në datën e mbylljes, palët bien dakord për:

- Të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të miratuar dhe autorizuar këtë Marrëveshje si dhe dokumenta të tjera në lidhje me to.
- Të njoftojnë Drejtoritë Rajonale Tatimore ku janë të regjistruara si subjekt në lidhje me operacionin e bashkimit.
- Të ndërmarrin çdo veprim për depozitimin e të gjithë dokumentacionit pranë QKB-së brenda afateve ligjore.
- Kalimin e të punësuarëve nga shoqëria e përthithur tek shoqëria përthithëse pas procesit të mbylljes.

Deklarimet dhe garancitë

Deklarimet dhe garancitë e shoqërisë përthithëse "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a

Shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a dhe përfaqësuesi i saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë Marrëveshje dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.

Shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a nuk është në proces falimentimi, në shkrirje apo në proces likuidimi.

Deklarimet dhe garancitë e shoqërisë së përthithur "Tipografia Ushtarake" sh.a

Shoqëria "Tipografia Ushtarake"sh.a dhe përfaqësuesi i saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë Marrëveshje dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.

Shoqëria "Tipografia Ushtarake"sh.a nuk është në proces falimentimi, në shkrirje apo në proces likuidimi.

Konfidencialiteti

Palët do të trajtojnë në mënyrë konfidenciale të gjitha informacionet e marra dhe të përfituara si rezultat i realizimit të kësaj Marrëveshje, që ka të bëjë me negociatat si dhe me çdo dokument tjetër që referohet nga kjo Marrëveshje.

Palët mund të japin informacion një pale të tretë, i cili mund të konsiderohet konfidencial nëse:

- Kërkohet me ligj ose me qëllim të ndonjë procedure ligjore
- Kërkohet nga ndonjë institucion qeveritar
- Me miratimin paraprak dhe me shkrim të palës tjetër.

Të përgjithshme

Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesmarrëse në këtë procedurë bashkimi me përthithje, do të hartojnë sipas ligjit (neni 216) një raport të hollësishem, në të cilën do të shpjegohen marëveshja e bashkimit, baza ligjore dhe ekonomike për të, vështirësitë e veçanta të cilat mund të jenë hasur. Raporti do të përshkruajë dhe pasojat e këtij bashkimi mbi punëmarrësit e këtyre shoqërive.

Projektmarëveshja dhe raporti i bashkimit do të depozitohen sipas ligjit në QKB, jo më vonë se 1 muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, për marrjen e vendimit të përcaktuar në nenin 218 të ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", në mënyrë të detyrueshme do të publikohen pasqyrat financiare vjetore, raportet përkatëse të ecurisë së veprimtarive të të dyja shoqërive, për të paktën tri vitet e fundit.

Autorizohet Znj. Fabrida Drenu (Hoxha), të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për depozitimin e të gjitha akteve për realizimin e procedurës së bashkimit me përthithje.

Zgjidhja e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë para datës së mbylljes me aprovimin me shkrim të të dyja palëve.

Kjo Marrëveshje mund të përfundojë nga secila palë me anë të njoftimit me shkrim te pala tjetër, para datës së mbylljes, nëse bashkimi nuk përfundon.

Të ndryshme

Të gjitha komunikimet, njoftimet dhe shpalljet e kërkuara nga kjo Marrëveshje do të dorëzohen dorazi ose me anë të postës në adresat si më poshtë vijon: (palët do të njoftohen për ndryshimet e adresave)

Shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a

Adresa Xhanfise Keko, Tirane

Në vëmendje të Z. Besmir HYSA

Shoqëria "Tipografia Ushtarake" sh.a

Adresa Zenel Stefo, Tirane

Në vëmendje të Znj. Fabiola DRINI (HOXHA)

Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshje nuk do të jetë i vlefshëm përveçëse me shkrim dhe e nënshkruar nga të dyja palët.

Kjo Marrëveshje u hartua sot në date 19.02.2021....., në 6 kopje origjinale dhe u nënshkrua nga:

Shoqëria

Shtypshkronja e Letrave me Vlerë

Përfaqësuar nga:

Z. Besmir HYSA administrator i shoqërisë

Shoqëria

Tipografia Ushtarake

Përfaqësuar nga:

Znj. Fabiola DRINI (HOXHA) administrator i shoqërisë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

VENDIM I ASAMBLESË SË PERGJITHSHME TE AKSIONARËVE

Nr. 1 Datë 4 / 1 / 18

PËR
BASHKIMIN ME PËRTHITHJE TË TË " TIPOGRAFIA USHTARAKE" SHA TIRANË, NGA "SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË" SHA TIRANË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare " i ndryshuar, statutit të shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sha Tiranë dhe statutit të shoqërisë " Tipografia Ushtarake " sha Tiranë, me cilësinë e aksionarit të vetëm të të dy shoqërive;

URDHËROJ:

1. Bashkimin me përthithje të shoqërisë " Tipografia Ushtarake" sha Tiranë, nga shoqëria " Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sha Tiranë.
2. Të hartohet marrëveshja dhe raporti i bashkimit sipas nenit 216 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2014 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
3. Shoqëria e re përthithëse do të quhet " Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sha Tiranë.
4. Administratori i shoqërisë përthithëse do të jetë Z. Artan Gjoka, Administratori aktual i shoqërisë " Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sha Tiranë.
5. Eksperti Kontabël i Autorizuar Znj. Anita Pulaj të hartojë raportin e bashkimit, sipas nenit 217 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2014 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
6. Shoqëria " Tipografia Ushtarake" sha Tiranë pas përfundimit të bashkimit, vlerësohet e prishur, sipas nenit 220 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2014 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, ndaj çregjistrohet nga QKB, sipas seksionit V të Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2207 " Për regjistrimin e biznesit".
7. Të zmadhohet kapitali i shoqërisë përthithëse sipas vlerës së përcaktuar nga Eksperti kontabël i Autorizuar.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Arben Ahmetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË - TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË SH.A - SEKRETARIA

503
4.10.10.18

VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT SKENDERBEUT · 2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

17067/3

Nr. 117 Datë 3.10.18

3.10.18

PËR

LIRIM ADMINISTRATORI

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe statutit të shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" Tiranë, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë,

VENDOSA:

1. Lirimin e Z.Artan Gjoka, nga detyra e Administratorit të shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sha Tiranë.

2. Marrëdhëniet financiare rregullohen sipas legjislacionit në fuqi.

3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, i ndryshuar " Për Regjistrimin e Biznesit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

4. Ngarkohet Drejtoria e shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Arben Ahmetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË · TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË SHA

Nr 512 Prot **Tiranë 15 . 10. 2018**

Vendim Nr. 13 i Këshillit Mbikëqyrës

Në mbledhjen e tij te rradhës më datë 15 / 10 /2018, Këshilli Mbikëqyrës i Shoqerisë " Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sha , ku morën pjesë të gjithë anëtarët e tij , në bazë te ligjit Nr.9901 , datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare ,statutit te shoqerise Neni 9/1 ndryshuar me vendim nr.72/1 datë 15.10.2018 te Asamblesë së Aksionarit :

VENDOSI

1. Të emërojë Z. Besmir Hysa Administrator të shoqërisë " Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sha
2. Afati i emërimit për një periudhë 3 vjecare .
3. Ngarkohet drejtoria e "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" të depozitojë Vendimin në QKB brënda afateve ligjore.

Këshilli Mbikeqyres:

Z. Lavdrim Sahitaj	Kryetar
Z.Ervin Mete	Anëtar
Z.Bledi Rrapushi	Anëtar
Z.Enton Duro	Anëtar
Z.Ismet Lala	Anëtar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

21. 6 '18

11867 **VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT**

Nr. 93/1 **Datë** 21. 6. 18

PËR

EMËRIM ADMINISTRATORI

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901 Nr. 7926, datë 20.4.1995 "Transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në shoqëri tregtare" të ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sha Tiranë;

VENDOSA:

1. Emërimin e Znj. Fabjola Hoxha, në detyrën e Administratorit të shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sha Tiranë.

2. Marrëdhëniet financiare rregullohen sipas legjislacionit në fuqi.

3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, i ndryshuar " Për Regjistrimin e Biznesit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

4. Ngarkohet Drejtoria e shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Arben Ahmetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E FINANCAVE TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

21.6.18

11867

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT

Nr. 93 **Datë** 21.6.18

PËR

LIRIM ADMINISTRATORI

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901 Nr. 7926, datë 20.4.1995 "Transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore në shoqëri tregtare" të ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sha Tiranë, për keq menaxhim të shoqërisë, moszbatimin e kompetencave të përcaktuara në ligj si dhe për zvarritje të procedurës së bashkimit me përthithje me " Shtypshkronja e Letrave me Vlere" sha Tiranë;

VENDOSA:

1. Lirimin e Znj. Xheni Krypi, nga detyra e Administratorit të shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sha Tiranë.

2. Marrëdhëniet financiare rregullohen sipas legjislacionit në fuqi.

3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, i ndryshuar " Për Regjistrimin e Biznesit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32.36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.

4. Ngarkohet Drejtoria e shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Arben Ahmetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË · TIRANË

423
Dt. 14.09.2020

Tirane me 14/09/2020

Shkrese perçjellese

Drejtuar: Shoqerise" Shtypshkronja e letrave me vlere" Sha,
Tirane

Lenda: Dergimi i Raporteve per Bashkimi me përthithje i shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a, nga shoqëria "Shtypshkronja e letrave me vlerë" sh.a.

Ne zbatim te Urdhri Nr. 1 , date 04/01/2018 i Ministrit te Financave dhe Ekonomise "per Bashkimin me Perthithje te Shoqerise " Tipografia Ushtarake" sha nga shoqeria "Shtypshkronja e Letrave me Vlere" sha" sha, bashkangjitur ju dergojme:

1. Tre kopje origjinale te Raportit te Audituesit Ligjor, Anita Pulaj, per Bashkimi me përthithje i shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a, nga shoqëria "Shtypshkronja e letrave me vlerë" sh.a.
2. Kopje ID dhe Kopje License te Audituesit Ligjor

Auditues Ligjor

Anita Pulaj

Ekspertë Kontabel e Autorizuar
I.E.K.A
Anita PULAJ
NUIS K31512115F
Licence Nr.155
TIRANA - ALBANIA

BLV. Gjergj Fishta, Pall G& P, hyrja II, Kati II,mbi Credins Bank, Tirane,
Nr. Kontakti Cel.0692087743 , e-mail pulaj_anita@yahoo.com

RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PER BASHKIMIN ME PERTHITHJE TE SHOQERISE

"TIPOOGRAFIA USHTARAKE"

NGA SHOQERIA

" SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERE" SHA

TIRANE

RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PER BASHKIMIN ME PERTHITHJE TE SHOQERISE "TIPOOGRAFIA USHTARAKE" NGA SHOQERIA " SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERE" SHA

Drejtuar: Shoqërsisë " Tipografia Ushtarake" sha

Shoqërsisë " Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sha

Në përfundim të misionit të ngarkuar nga Ministri I Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e Aksionerit të vetëm të të dyja shoqërive me Urdhri Nr. 1, date 04/01/2018 e caktuar si Auditues Ligjor (Ekspert Kontabël të Regjistruar) Për pergatitjen e raportit per bashkimin me përthithje të shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a, nga shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a, kemi kënaqësine tju paraqesim Raportin e Audituesit Ligjor (Ekspert Kontabël të Regjistruar) Për bashkimin me përthithje të shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a, nga shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a, si dhe vlerësimin e ndryshimit të kapitalit të shoqërise "Shtypshkronja e letrave me vlerë" sh.a nga përthithja e shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a si më poshtë:

Me vendimin Nr.1 datë 04/01/2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë është urdhëruar:

1. Bashkimi me përthithje i shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a, nga shoqëria "Shtypshkronja e letrave me vlerë" sh.a.
2. Të hartohet marrëveshja dhe raporti i bashkimit sipas nenit 216 të ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008 " Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar
3. Shoqëria e re përthithëse do të quhet "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë"sh.a Tiranë.
4. Administratori i shoqërisë përthithëse do të jetë Z. Besmir HYSA, administrator aktual i shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë"sh.a sh.a Tiranë.
5. Eksperti kontabël Znj. Anita Pulaj të hartojë raportin e bashkimit, sipas nenit 217 të ligjit 9901, datë 14/04/2008 " Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar
6. Shoqëria " Tipografia Ushtarake" sh.a, Tiranë pas përfundimit të bashkimit, vlerësohet e prishur, sipas nenit 220 të ligjit 9901, datë 14/04/2008 " Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar, ndaj crregjistrohet nga QKB, sipas seksionit V të ligjit Nr.9723, datë 03/05/2007 " Për Regjistrin e Biznesit.
7. Të zmadhohet kapitali i shoqërisë përthithëse sipas vlerës së përcaktuar nga Eksperti kontabël.

RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PER BASHKIMIN ME PERTHITHJE TE SHOQERISE "TIPOOGRAFIA USHTARAKE" NGA SHOQERIA " SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERE" SHA

Drejtuar: Këshillit mbikqyrës të shoqërsisë " Tipografia Ushtarake" sha

Këshillit mbikqyrës të shoqërsisë " Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sha

Në përfundim të misionit të ngarkuar nga Ministri I Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e Aksionerit të vetëm të të dyja shoqërive me Urdhri Nr. 1, date 04/01/2018 e caktuar si Auditues Ligjor (Ekspert Kontabël të Regjistruar) Për pergatitjen e raportit per bashkimin me përthithje të shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a, nga shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a, kemi kënaqësine tju paraqesim Raportin e Audituesit Ligjor (Ekspert Kontabël të Regjistruar) Për bashkimin me përthithje të shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a, nga shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a, si dhe vlerësimin e ndryshimit të kapitalit të shoqërise "Shtypshkronja e letrave me vlerë" sh.a nga përthithja e shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a si më poshtë:

Me vendimin Nr.1 datë 04/01/2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë është urdhëruar:

1. Bashkimi me përthithje i shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a, nga shoqëria "Shtypshkronja e letrave me vlerë" sh.a.
2. Të hartohet marrëveshja dhe raporti i bashkimit sipas nenit 216 të ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008 " Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar
3. Shoqëria e re përthithëse do të quhet "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë"sh.a Tiranë.
4. Administratori i shoqërisë përthithëse do të jetë Z. Besmir HYSA, administrator aktual i shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë"sh.a sh.a Tiranë.
5. Eksperti kontabël Znj. Anita Pulaj të hartojë raportin e bashkimit, sipas nenit 217 të ligjit 9901, datë 14/04/2008 " Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar
6. Shoqëria " Tipografia Ushtarake" sh.a, Tiranë pas përfundimit të bashkimit, vlerësohet e prishur, sipas nenit 220 të ligjit 9901, datë 14/04/2008 " Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar, ndaj crregjistrohet nga QKB, sipas seksionit V të ligjit Nr.9723, datë 03/05/2007 " Për Regjistrin e Biznesit.
7. Të zmadhohet kapitali i shoqërisë përthithëse sipas vlerës së përcaktuar nga Eksperti kontabël.

I. BASHKIMI I SHOQERIVE

Misioni ynë ka të bëjë me verifikimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm pranë shoqërive që marrin pjesë në operacionin e bashkimit. Ne kemi verifikuar nëse vlerat përkatëse të shoqërive që marrin pjesë në bashkim janë të sakta dhe në përputhje me marrëveshjen e hartuar dhe raporti I këmbimit është I drejt dhe I paanshëm. Drejtimi I të dyja shoqërive (bazuar në vendimin Nr.1 datë 04/01/2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë) kanë hartuar marëveshjet përkatëse të bashkimit ku:

- Shoqëria "Shtypshkronja e letrave me vlerë"sh.a, do të jetë Shoqëri Përthithëse
- Shoqëria "Tipografia Ushtarake"sh.a, do të jetë Shoqëri e Përthithur

Bashkimi me përthithje është menduar për përmirësimin e performancës ekonomike, te Shoqërisë "Tipografia Ushtarake"sh.a, pasi ka vite që është në vështirësi financiare, njekohësisht për arritjen e objektivave të Shoqërisë "Shtypshkronja e letrave me vlerë" sh.a, si rritjen e investimeve në teknologji për të ofruar shërbime sa më të mira të klientëve të saj , rritjen e marzheve të fitimit.

Në marëveshjen e bashkimit është përcaktuar që si bazë mbi të cilat do të bëhet bashkimi do të jenë pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2019

Në aspektin e kontabilitetit të gjitha operacionet e veprimtarisë të kryera prej Shoqërisë "Tipografia Ushtarake"sh.a nga data 01 janar 2020 deri në datën e regjistrimit përfundimtar të procesit të bashkimit pranë QKB-së, datë në të cilën do të ndodhë çregjistrimi pa likuidim i Shoqërisë "Tipografia Ushtarake"sh.a, do të konsiderohen si të kryera nga shoqëria Përthithëse "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë"sh.a, dhe regjistrimet kontabël përkatëse do të merren në librat e saj.

Baza ligjore:

- Nenet 216-225 të ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar
- Urdhri Nr. 1 , date 04/01/2018 I Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e aksionerit të vetëm të të dyja shoqërive, për emërimin tonë Ekspertit Kontabël të Regjistruar Për bashkimin me përthithje të shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a, nga shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a

Dokumentacioni ku jemi bazuar:

- Bilanci kontabël I Shoqërisë "Shtypshkronja e letrave me vlerë"sh.a I datës 31 dhjetor 2019, si dhe të gjithë inventarët e llogarive që janë përdorur si bazë për përgatitjen e Marëveshjes së Bashkimit.
- Bilanci kontabël I Shoqërisë "Tipografia Ushtarake"sh.a I datës 31 dhjetor 2019, si dhe të gjithë inventarët e llogarive që janë përdorur si bazë për përgatitjen e Marëveshjes së Bashkimit.
- Projektmarëveshja e hartuar nga të administratorët e të dy shoqërive
- Marëveshjet përkatëse të bashkimit të secilës shoqëri.

Të dhënat për shoqëritë që do bashkohen

1. **Shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a do të quhet "Shoqëria Përthithëse".**

- Statusi juridik " Shoqëri Anonime" me kapital 100% shteëtror.
- Kapital të regjistruar prej 430,238,000 lekë, i ndarë në 430,238 aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksion
- Selia tek ish "Tipografia Ushtarake" Tiranë
- Datë themelimi më 01/09/2008
- Administrator i Shoqërisë Z. Besmir HYSA
- Shtypshkronja e Letrave me Vlerë sh.a do të quhet "Shoqëria Përthithëse".

2. **Shoqëria "Tipografia Ushtarake"sh.a do të quhet Shoqëria e Përthithur.**

- Statusi juridik " Shoqëri Anonime" me kapital 100% shtetëror.
- Kapital të regjistruar prej 66,857,000 lekë, i ndarë në 66,857 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion
- Selia Rruga "Qemal Stafa". Tiranë
- Datë themelimi më 11/07/1997
- Administrator i Shoqërisë Znj. Fabiola HOXHA
- Tipografia Ushtarake"sh.a do të quhet "Shoqëria e Përthithur".

Per realizimin e bashkimit e të dy shoqërive asamblete respektive të të dyja shoqërive kanë vendosur:

Në bazë të kushteve të Projektmarëveshjes së lidhur shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a do të përthithë shoqërinë "Tipografia Ushtarake" sh.a në Datën e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit që është data e miratimit të projektmarveshjes nga aksioneri I vetëm I të dyja shoqërive dhe I depozitimit të këtyre dokumentave në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit.

Shoqëria "Tipografia Ushtarake" sh.a do ti transferojë shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a tërësinë e kapitaleve neto duke përfshirë dhe ato që rezultojnë nga operacionet e kryera gjatë periudhës ushtrimore deri në Datën Efektive të Bashkimit.

Të dyja shoqëritë që marrin pjesë në procesin e bashkimit me përthithje zotërohen nga i njëjti aksioner, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Kapitali i shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a, nga perthithja e Shoqërise "Tipografia Ushtarake" sh.a Zvogelohet me vlerën 9,575,000 lekë, dhe shuma per 959 lekë do të kalojë në Zvogelimin e zërit rezerva për efekt të rrumbullakimit të vlerës së aksioneve. Pas Zvogelimit nga procesi I bashkimit Kapitali i "Shoqërisë Përthithëse" nga 430,238,000 lekë bëhet 420,663,000 lekë, i ndarë në 420,663 aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksion

Data e bashkimit është data 31/12/2019, që do të thotë se të gjitha operacionet e kryera nga "Tipografia Ushtarake" sh.a që nga data 01/01/2020 dhe deri në datën e Regjistrimit përfundimtar në QKB do të konsiderohen si të kryera nga "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a.

Anëtarët e organeve drejtuese të shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë"sh.a në datën e realizimit përfundimtar të bashkimit do të vazhdojnë të jenë anëtarët e organeve drejtuese të Shoqërisë Përthithëse.

Statuti i shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë"sh.a, mbas ndryshimeve që mund të bëhen do të jetë Statuti i Shoqërisë Përthithëse.

Administrator i Shoqërisë Përthithëse do të jetë Z. Besmir HYSA, i cili do të ushtrojë kompetencat e administrimit të shoqërisë së bashkuar sipas ligjit dhe statutit të shoqërisë.

Selia e Shoqërisë Përthithëse do të jetë Selia e Shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë":
ish "Tipografia Ushtarake" Tiranë
Në marëveshjen e bashkimit është përcaktuar që si bazë mbi të cilat do të bëhet bashkimi do të jenë pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2019

Pasqyrat financiare të shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a në datë 31/12/2019 janë si më poshtë:

	Periudha Raportuese	**Periudha Para ardhese**
AKTIVET		
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare	9,732,098	0
Investime		
Te drejta te arketueshme		
Nga aktiviteti i shfrytezimit	93,900	0
Te tjera	81,876	79,686
Inventaret		
Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	194,466	2,375,950
Shpenzime te shtyra	0	0
Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara	0	0
Totali i aktiveve afatshkurtra	**10,102,340**	**2,455,636**
Aktive afatgjate		
Aktive financiare		
Aktive materiale		
Toka dhe ndertesa	20,560,276	21,426,159
Impiante dhe makineri	136,540	170,675
Te tjera instalime dhe pajisje	69,295	87,875
Aktivet biologjike	0	0
Aktive jo materiale		
Aktivet tatimore te shtyra	0	0

Totali i aktiveve afatgjata	**20,766,111**	**21,684,709**
TOTALI I AKTIVEVE	**30,868,451**	**24,140,345**
DETYRIMET DHE KAPITALI		
Detyrime afatshkurtra		
Titujt e huamarrjes	47,654	2,850
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	2,608,383	1,840,154
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore	4,295,230	1,030,629
Te pagueshme per detyrime tatimore	4,085,450	7,165,942
Te tjera te pagueshme	29,407,693	15,852,421
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara	0	0
Te ardhura te shtyra	0	0
Provizione	0	0
Totali i detyrimeve afatshkurta	**40,444,410**	**25,891,996**
Detyrime afatgjata		
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara	0	0
Te ardhura te shtyra	0	0
Provizione		
Detyrime tatimore te shtyra	0	0
Totali i detyrimeve afatgjata	**0**	**0**
Detyrime totale	**40,444,410**	**25,891,996**
Kapitali dhe Rezervat		
Kapitali i nenshkruar	66,857,000	66,857,000
Primi i lidhur me kapitalin	0	0
Rezerva rivleresimi	0	0
Rezerva te tjera		
Rezerva ligjore	14,269,127	14,269,127
Rezerva statutore	1,435,127	1,435,127
Fitimi/(humbja) e pashperndare	(84,312,905)	(91,164,911)
Fitimi/(humbja) e periudhes	(7,824,308)	6,852,006
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike	**(9,575,959)**	**(1,751,651)**
Interesa jo-kontrollues		
Totali i kapitalit	**(9,575,959)**	**(1,751,651)**
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	**30,868,451**	**24,140,345**

Pasqyrat financiare të shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë"sh.a në datë 31/12/2019 janë si më poshtë:

	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
AKTIVET		
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare	186,658,502	214,140,981
Investime		
Te drejta te arketueshme		
Nga aktiviteti i shfrytezimit	162,750,183	103,939,122
Te tjera	104,375,346	6,289,822
Inventaret		
Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	94,916,319	118,088,677
Produkte te gatshme	430,436	766,332
Shpenzime te shtyra	0	0
Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara	0	0
Totali i aktiveve afatshkurtra	**549,130,786**	**443,224,934**
Aktive afatgjate		
Aktive financiare		
Aktive materiale		
Toka dhe ndertesa	39,653,937	41,740,986
Impiante dhe makineri	47,287,503	58,747,400
Te tjera instalime dhe pajisje	6,844,168	7,429,058
Aktivet biologjike		
Aktive jo materiale		
Koncensione, patenta, licensa, makra tregtare, te drejta dhe aktive te ngjashme	272,039	320,046
Aktivet tatimore te shtyra		
Totali i aktiveve afatgjata	**94,057,647**	**108,237,490**
TOTALI I AKTIVEVE	**643,188,433**	**551,462,424**
DETYRIMET DHE KAPITALI		
Detyrime afatshkurtra		
Titujt e huamarrjes	9,564,081	0
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	16,401,343	24,298,975
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore	1,748,234	1,721,480
Te pagueshme per detyrime tatimore	10,557,857	4,202,588
Te tjera te pagueshme	88,353	36,450
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		

Te ardhura te shtyra		
Provizione		
Totali i detyrimeve afatshkurta	**38,359,868**	**30,259,493**
Detyrime afatgjata		
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara	7,764,141	7,902,695
Te ardhura te shtyra		
Provizione		
Detyrime tatimore te shtyra		
Totali i detyrimeve afatgjata	**7,764,141**	**7,902,695**
Detyrime totale	**46,124,009**	**38,162,188**
Kapitali dhe Rezervat		
Kapitali i nenshkruar	430,238,000	160,000,000
Primi i lidhur me kapitalin	0	0
Rezerva rivleresimi	0	0
Rezerva te tjera	0	0
Rezerva ligjore	22,457,849	19,268,191
Rezerva statutore	54,224,187	269,280,346
Rezerva te tjera	884	958,538
Fitimi/(humbja) e pashperndare	0	0
Fitimi/(humbja) e periudhes	90,143,504	63,793,161
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike	**597,064,424**	**513,300,236**
Interesa jo-kontrollues		
Totali i kapitalit	**597,064,424**	**513,300,236**
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	**643,188,433**	**551,462,424**

Pasqyrat financiare të shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë"sh.a në datë 31/12/2019 duke përthithur elementët e aktivit dhe të pasivit të Pasqyrave finnacuiare të shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a në datë 31/12/2019 jnaë si më poshtë:

	Bilanci I bashkimit 31/12/2019	Shoqëria përthithëse 31/12/2019	Shoqëria e përthithur 31/12/2019
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	196,390,600	186,658,502	9,732,098
Investime			
Te drejta te arketueshme			
Nga aktiviteti i shfrytezimit	162,844,083	162,750,183	93,900
Te tjera	104,457,222	104,375,346	81,876
Inventaret			
Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	95,110,785	94,916,319	194,466
Produkte te gatshme	430,436	430,436	0
Shpenzime te shtyra	0	0	0
Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara	0	0	0
Totali i aktiveve afatshkurtra	**559,233,126**	**549,130,786**	**10,102,340**
Aktive afatgjate			
Aktive financiare			
Aktive materiale			
Toka dhe ndertesa	60,214,213	39,653,937	20,560,276
Impiante dhe makineri	47,424,043	47,287,503	136,540
Te tjera instalime dhe pajisje	6,913,463	6,844,168	69,295
Aktivet biologjike	0		0
Aktive jo materiale			
Koncensione, patenta, licensa, makra tregtare, te drejta dhe aktive te ngjashme	272,039	272,039	0
Aktivet tatimore te shtyra	0		0
Totali i aktiveve afatgjata	**114,823,758**	**94,057,647**	**20,766,111**
TOTALI I AKTIVEVE	**674,056,884**	**643,188,433**	**30,868,451**
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrime afatshkurtra			
Titujt e huamarrjes	9,611,735	9,564,081	47,654
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	19,009,726	16,401,343	2,608,383
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore	6,043,464	1,748,234	4,295,230
Te pagueshme per detyrime tatimore	14,643,307	10,557,857	4,085,450
Te tjera te pagueshme	29,496,046	88,353	29,407,693

Te pagueshme per shpenzime te konstatuara	0		0
Te ardhura te shtyra	0		0
Provizione	0		0
Totali i detyrimeve afatshkurta	**78,804,278**	**38,359,868**	**40,444,410**
Detyrime afatgjata			
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara	7,764,141	7,764,141	0
Te ardhura te shtyra	0		0
Provizione			
Detyrime tatimore te shtyra	0		0
Totali i detyrimeve afatgjata	**7,764,141**	**7,764,141**	**0**
Detyrime totale	**86,568,419**	**46,124,009**	**40,444,410**
Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali i nenshkruar	420,663,000	430,238,000	66,857,000
Primi i lidhur me kapitalin	0	0	0
Rezerva rivleresimi	0	0	0
Rezerva te tjera		0	
Rezerva ligjore	22,457,849	22,457,849	14,269,127
Rezerva statutore	54,224,112	54,224,187	1,435,127
Rezerva te tjera		884	0
Fitimi/(humbja) e pashperndare	0	0	(84,312,905)
Fitimi/(humbja) e periudhes	90,143,504	90,143,504	(7,824,308)
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike	**587,488,465**	**597,064,424**	**(9,575,959)**
Interesa jo-kontrollues			
Totali i kapitalit	**587,488,465**	**597,064,424**	**(9,575,959)**
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	**674,056,884**	**643,188,433**	**30,868,451**

Në përfundim të verifikimeve të kryera konkludojmë se:

- Marëveshja për bashkimin me përthithje të shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a nga shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë"sh.a është në përputhje me kërkesat e parashikuara në Nenet 216-225 të Ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare" i ndryshuar

- Operacioni I bashkimit nuk cënon të drejtat e Aksionerit të vetëm të Shoqërisë Përthithëse dhe as të drejtat e punonjësëve dhe të kreditorëve të shoqërisë së përthithur, të drejtat dhe detyrimet janë marrë përsipër nga Shoqëria Përthithëse

- Elementët e pasurisë, aktivet dhe pasivet e shoqërisë së përthithur që do ti kalojnë shoqërisë përthithëse në momentin e realizimit të bashkimit mbi pasqyrat financiare të datës 31/12/2019 janë të evidentuara në mënyrë analitike në pasqyrat shoqëruese që janë pjesë e marëveshjes së bashkimit me përthithje të hartuar nga të dy administratorët e dy shoqërive respektive.

- Nga procesi I bashkimit është bërë eleminimi i vlerës 24,000,000 leke, e paraqitur në zërin e "Kërkesave të arkëtueshme" tek Shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a, me vlerën 24,000,000 lekë e paraqitur në zërin e "Detyrime afat shkurtëra" tek shoqëria "Tipografia Ushtarake" sh.a, si të drejta dhe detyrime ndaj njëra tjetrës. Shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a i ka kaluar fonde për mungese likuiditeti shoqërisë "Tipografia Ushtarake" sh.a,

- Aksionet në "Shoqërinë Përthithëse" zotërohen vetëm nga një aksioner, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duke e konsideruar këtë fakt, nuk ka kushte të ndarjes së aksioneve, si dhe përcaktimin e një date për ndarjen e fitimit.
  Ky operacion bashkimi me përthithje nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë.

- Kapitali i "Shoqërisë Përthithëse" është në shumën 430,238,000 lekë, i ndarë në 430,238 aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksion. Nga ndryshimet mëparshme të kapitalit të kësaj shoqërie numri i aksioneve nuk ka ndryshuar, duke zmadhuar kapitalin me rritjen vlerës për secilin aksion.

  Kapitali i shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a, nga perthithja e Shoqërise "Tipografia Ushtarake" sh.a Zvogelohet me vlerën 9,575,000 lekë, dhe shuma per 959 lekë do të kalojë në Zvogelimin e zërit rezerva për efekt të rrumbullakimit të vlerës së aksioneve. Pas Zvogelimit nga procesi I bashkimit Kapitali i "Shoqërisë Përthithëse" nga 430,238,000 lekë bëhet 420,663,000 lekë, i ndarë në 420,663 aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksion

Veprimet ne kontabilitetin e shoqërisë përthithëse janë si më poshte:

Shtim të aktivit :

Aktiveve monetare	9,732,098
Të drejta të arkëtueshme	175,776
Inventarët	194,466
Aktivet materiale	20,766,111

Shtim të pasivit:

Detyrime afatshkurtra	40,444,410

Grupi I kapitalit ndryshon si më poshtë:

Kapitali I regjistrua r zvogelohet	-9,575,000
Rezerva statutore nga bashkimi zvogelohet	-959
Rezerva statutore (sistemim) zmadhohet	884
Rezerva te tjera (sistemim) zvogelohet	-884

II. ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Ne vendimin Nr.1 datë 04/01/2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, pika 7, është përcaktuar zmadhimi I kapitali i shoqërisë përthithëse sipas vlerës së përcaktuar nga Eksperti kontabël.

Nga verfifikimi I pasqyrave financiare në datë 31/12/2019, datë e përcaktuar në marëveshjen e bashkimit të shoqëris "Tipografia Ushtarake" kemi konkluduar se gjendja e kapitaleve të veta është si më poshtë:

I		**Aktivet**	**31/12/2019**
	1	Aktiveve monetare	9,732,098
	2	Të drejta të arkëtueshme	175,776
	3	Inventarët	194,466
	4	Aktivet materiale	20,766,111
		Totali I aktiveve	**30,868,451**
II		**Detyrimet**	
	1	Detyrime afatshkurtra	40,444,410
	2	Detyrime afatgjata	0
		Total detyrime	**40,444,410**
III		**Aktivet Neto ose kapitalet e veta (I-II)**	**-9,575,959**

Kapitali i shoqërisë "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a (shoqëri përthithëse) nuk zmadhohet por zvogëlohet r shumën 9,575,000 lekë, ndërsa shuma prej 959 lekë kalon ne rezerva për efekt të rumbullakosjes.

Efekti i ndryshimeve te kapitalit eshte si me poshte:

Kapitali i regjistruar para bashkimit	**430,238,000 lekë**
Zvogelimi i kapitalit nga bashkimi	**9,575,000 lekë**
Kapitali i regjistruar pas zvogelimit behet	**420,663,000 lekë**

Kapitali i regjistruar "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a Tiranë pas Zvogelimit është 420,663,000 lekë (Katërqindenjëzetmije e gjashtëqindegjashtedhjetetremije), cili përbëhet nga 420,663 aksione me vlerë 1000 lekë/ aksioni.

Ky kapital zoterohet 100% nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Sipas opinionit tim jane zbatuar te gjitha kerkesat e ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe ligjit 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" per bashkimin e shoqerive me perthithje si edhe zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë përthithse si rezultuar si pasojë e bashkimit me përthithje në datë 31/12/2019.
Ky raport mbahet ne 4 (kater) kopje të njëjta.

Bashkëlidhur këtij raporti është:

- Bilanci i shoqërise përthithëse në 31/12/2019
- Bilanci i shoqërise së përthithur ne date 31/12/2019

Auditues Ligjor **Tiranë më 14/09/2020**

Anita Pulaj (pulaj_anita@yahoo.com; cel:0692087743)

Ekspert Kontabel i Autorizuar
I.E.K.A
Anita PULAJ
NUIS K31512115F
Licence Nr.155
TIRANA - ALBANIA

Emertimi dhe Forma ligjore:	**"TIPOGRAFIA USHTARAKE" SH.A**
NIPT –i:	**J61821057H**
Adresa e Selise:	**Tirane**
Data e krijimit:	**11/07/1997**
Nr. I Regjistrit Tregtar	**17628**
Veprimtaria Kryesore:	**Prodhim, tregtim libra artistik, rregullore, bllogje, etj**

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr 2
dhe Ligjit 25/2018, date 10.05.2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare")

VITI 2019

Pasqyrat Financiare jane individuale
Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek
Pasqyrat Financiare nuk jane te rrumbullakosura
Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2019-31.12.2019
Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare 05.06.2020

Pasqyra e Pozicionit Financiar	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
AKTIVET		
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare	9,732,098	0
Investime		
*Ne tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit **	0	0
Te drejta te arketueshme		
Nga aktiviteti i shfrytezimit	93,900	0
